



# RAPORT I RAN

## Fëmijët e kthyer nga zonat e konflikteve

### Hyrje

Ky dokument shqyrton mënyra për t'iu përgjigjur – nga perspektiva e një specialisti - situatës së fëmijëve që kthehen në Evropë që kanë lindur ose kanë udhëtuar drejt territoreve të kontrolluara nga ISIS-i në Siri/Irak si edhe fëmijëve evropianë që kanë udhëtuar nga territori i ISIS-it drejt Evropës, si rezultat i zhvendosjes së detyruar.

Është e vështirë të llogaritet numri i fëmijëve që kanë udhëtuar nga Evropa drejt Irakut dhe Sirisë; llogaritjet për shtetet individuale variojnë nga 24 në 70. Një fakt tjetër i panjohur është numri aktual i fëmijëve të lindur (ose që do të lindin) në Siri ose Irak nga prindër evropianë.

Sipas raporteve nga Këshilli i Sigurisë së OKB-së, këta fëmijë përdoren nga ISIS-i për të transportuar armë, për të mbrojtur pika strategjike, për të arrestuar civilë dhe për të kryer sulme vetëvrasëse. Gjithashtu, fëmijët janë veçanërisht vulnerabël ndaj indoktrinimit, duke i kthyer ata në mbështetës besnikë për organizatat terroriste. Këta fëmijë vuajnë, si për shkak të dhunës që përjetojnë ose ku marrin pjesë, por edhe për shkak të faktit se zhvillimi i tyre normal social, moral, emocional dhe njohës ndërpritet dhe dëmtohet nga përvoja e luftës. Gjithashtu, nga pasojat e konfliktit këta fëmijë janë të rrezikuar nga ekspozimi ndaj traumave shtesë për shkak të përvojës së procesit të migrimit dhe zhvendosjes (të detyruar). Ekspozimi ndaj traumave të shumta dhe të përsëritura përbën rrezik të konsiderueshëm për zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të fëmijëve dhe rrit rrezikun e çrregullimeve fizike dhe mendore në të ardhmen.

Dokumenti jep një përmbledhje të sfidave me të cilat përballen specialistët e parandalimit dhe shërbimet sociale në lidhje me trajtimin e traumave të fëmijërisë, kuptimin e përfshirjes në dhunë nga fëmijët e kthyer, mësimet nga arena të tjera, faktorët e rrezikut dhe rezistencës, identifikimin dhe punën me fëmijët e rrezikuar, rolin e familjes dhe efektin e përhapjes.



## Trajtimi i traumave të fëmijërisë

Ndërgjegjësimi për traumat duhet të jetë një aftësi kyçe e të gjithë individëve që punojnë me fëmijët e kthyer. Aftësia për të njohur shenjat dhe simptomat e traumës është thelbësore për interpretimin e saktë të sjelljes së fëmijëve dhe për të hartuar ndërhyrje të përshtatshme.

Për të zbutur ndikimin e traumave gjatë përfshirjes me shërbimet e mbështetjes, është e rëndësishme që të përdoret një përjasje me sistem familjeje (ku familja shihet si një njësi e vetme emocionale), të zbatohet një sistem me një punonjës kyç të dedikuar, dhe ndërhyrjet të fokusohen në çështjet kryesore të edukimit, punësimit, përballimit psikologjik dhe identitetit.

## Kuptimi i përfshirjes në dhunë nga fëmijët e kthyer

Është e dokumentuar mirë që fëmijët që bëhen ushtarë fëmijë e bëjnë këtë kryesisht të detyruar, për të mos pësuar ndëshkime alternative, duke përfshirë edhe dhunën seksuale, për të shmangur martesën e detyruar, dhe/ose në përpjekje për t'iu larguar varfërisë ekstreme. Pavarësisht mjeteve ose motivit të rekrutimit, provat psikologjike tregojnë paaftësinë e fëmijëve për të miratuar në mënyrë të mjaftueshme përfshirjen e tyre në aktivitete të dhunshme dhe mungesën e aftësisë së tyre për të kuptuar plotësisht pasojat e kësaj përfshirjeje. Pavarësisht kësaj dhe tepër problematike në rastin e ushtarëve fëmijë, fëmijët perceptohen se kanë *identitete të dyfishta si viktimë dhe autorë të krimeve* dhe kjo mund të ndikojë në zhvillimin dhe aplikimin e ndërhyrjeve.

## Mësimet nga arena të tjera

Është e qartë se një shqetësim kyç për shërbimet e sigurisë dhe specialistët është mundësia që për shkak të së kaluarës së tyre, kur të rriten fëmijët e kthyer mund të vazhdojnë përfshirjen e tyre në dhunë politike. Potenciali për dhunë është i panjohur dhe ka shumë të ngjarë të jetë i panjohshëm. Praktikën më të mira ekzistuese, kodet profesionale të etikës, protokollet e vendimmarrjes disiplinore dhe politika vendore dhe kombëtare duhet të drejtojnë mjetet për trajtimin e fëmijëve të kthyer dhe çdo zbulim të dhunës në të kaluarën ose të treguesve të dhunës në të ardhmen.

Për ish-ushtarët fëmijë ajo që dihet është se izolimi, diskriminimi dhe ekspozimi i mëtejshëm ndaj traumës në mungesë të shërbimeve të përshtatshme terapeutike mund të ndikojnë në përpjekjet integruese/rehabilituese. Plotësimi i nevojave bio-psikosociale të fëmijëve të kthyer duke maksimizuar mirëqenien e tyre dhe të familjeve të tyre si dhe reduktimi i pasojave afatgjata të traumave të tilla si shëndeti i lig, papunësia, niveli i ulët arsimor, dhe përfshirja me sistemin e drejtësisë penale, është mjeti më i përshtatshëm i garantimit të një rezultati pozitiv.

## Faktorët e rrezikut dhe të rezistencës

Si me të gjitha kërcënimet ndaj mirëqenies së fëmijës, ekzistojnë faktorë të përbashkët rreziku dhe mbrojtjeje. Stresi toksik si rezultat i ekspozimit ndaj *traumës së vazhdueshme* është akumulues në faktin se ka një efekt reagues sipas dozës; sa më i madh ekspozimi, aq më të mëdha rezultatet negative. Megjithatë, provat kanë treguar se fëmijët kanë aftësinë të *rikuperohen* nga trauma dhe të



zhvillojnë strategji rezistence kur krijohet dhe ruhet mjedisi i përshtatshëm; ndërtimi i rezistencës përmes krijimit të këtij mjedisi duhet të jetë fokusi kyç për çdo strategji ndërhyrjeje.

## Identifikimi dhe puna me fëmijët e rrezikuar

Politika më e përshtatshme për identifikimin e fëmijëve të kthyer në nevojë ndërhyrjeje duhet të jetë që të gjithë fëmijët që kthehen nga Siria presupozohen se kanë përjetuar trauma dhe kanë nevojë për ndërhyrje vetëm sipas kësaj baze. Nëse do të konsideronim fëmijët që mund të jenë indoktrinuar ose radikalizuar me ideologjinë ekstremiste të ISIS-it, sërish duhet të konstatojmë se, duke parë sa larg shkon ISIS-i për të ekspozuar fëmijët ndaj botëkuptimit të tyre, të gjithë fëmijët duhet të supozohet se kanë marrë njëfarë përfshirjeje me ideologjinë ekstremiste të ISIS-it. Kjo nuk do të thotë se të gjithë të kthyerit janë ekstremistë të dhunshëm, por që të kuptohet se ndaj fëmijëve do të jenë bërë përpjekje nga burime të ndryshme për t'i indoktrinuar dhe kështu mund ta kenë asimiluar këtë ideologji në veten e tyre, në konceptet e tyre për komunitetin dhe perceptimet e tyre për perëndimin.

## Roli i familjes

Ekziston nevoja të konsiderohet dinamika psiko-sociale e familjes dhe se si kjo është e rëndësishme për të kuptuar radikalizimin, dhe përkatësisht deradikalizimin brenda njësive të familjes. Në lidhje me deradikalizimin, mundësia që familja të ndikojë pozitivisht në këtë proces varet nga burimet e disponueshme për familjen, rrethet shoqërore të familjes dhe dinamikat unike të grupit të familjes. Karakteristika të tilla si punësimi i prindërve, shëndeti mendor, stabiliteti familjar, akses në akomodim privat, një sens vetëvendosjeje dhe akses në arsim dhe mbështetje, të gjitha këto janë të nevojshme për të garantuar që familja të ketë kapacitetin për t'u përfshirë në programet e ndërhyrjes për të asistuar fëmijët e kthyer.

Është gjithashtu e rëndësishme që të kuptojmë se mund të ketë raste ku familja është vetë faktori i rrezikut; sepse e dimë se ka prova të fëmijëve të sjellë nga prindërit në territore të kontrolluara nga ISIS-i. Në këto raste, pas kthimit të tyre, mund të jetë e nevojshme që të konsiderohet largimi i fëmijës nga familja; ky do të ishte opsioni absolutisht i fundit sepse ndikimi të fëmija do të jetë i konsiderueshëm dhe i paparashikueshëm.

## Efekti i përhapjes

Një çështje e spikatur në literaturën mbi radikalizimin, është efekti i përhapjes së mundshme që mund të kenë individët e radikalizuar te personat e përafërt të tyre. Në rastet kur fëmijë të rritur janë kthyer nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i dhe presupozohet se kanë qenë dëshmitarë ose pjesëmarrës në dhunën ekstreme, ekziston rreziku që këta fëmijë të jenë më pak të hapur ndaj ndërhyrjes dhe më pak të aftë të ndryshojnë për shkak të statusit të zhvillimit të tyre. Gjithashtu, dhe e mbështetur nga literatura e kriminalistikës që tregon influencat e grupeve të personave të afërt në kryerjen e krimeve, duhet të ketë shqetësime të konsiderueshme rreth përhapjes së ideve radikale mes personave të afërt. Në raste të tilla, një rol në mentorimin e fëmijës mund të luajnë



liderët e respektuar (nga fëmija) të komunitetit, ose drejtuesit e xhamisë që njohin kulturën përkatëse të të rinjve dhe që janë të aftë të komunikojnë në një nivel të përshtatshëm. Gjithashtu, ofruesit e edukimit mund të shërbejnë si mjet për të hapur interesa dhe rrethe alternative shoqërore për të rinjtë. Megjithatë, pavarësisht nga mosha e fëmijës, vazhdojnë të aplikohen zhvillimi i aftësive ndërpersonale, menaxhimi i emocioneve, pasja e një jete familjare të qëndrueshme etj. Përveç kësaj, është e rëndësishme që fëmijët më të rritur të menaxhohen në një shërbim të posaçëm me shërbimet kyçe (p.sh. psikologjike, edukative, pastorale) të përshtatura për nivelin e tyre të zhvillimit. Ata nuk duhet të përfshihen në shërbimet e të rriturve.

ISIS-i është aktiv në rekrutimin e fëmijëve për kauzën e tyre.<sup>1</sup>

Sipas Leila Zerrougu, Përfaqësuese Speciale për Fëmijët dhe Konfliktin e Armatosur, në përfaqësimin e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, fëmijët po përdoren nga ISIS-i për të transportuar armë, për të mbrojtur pika strategjike, për të arrestuar civilë dhe për të kryer sulme vetëvrasëse.<sup>2</sup> Raporte të tjera dokumentojnë përfshirjen e fëmijëve në prerje të kokave, përdorimin nga ana e tyre e municioneve luftarake dhe pjesëmarrjen në beteja.<sup>3</sup> Ndërkohë që një shumëllojshmëri raportesh kanë dokumentuar rolet që plotësojnë fëmijët, numri i fëmijëve të indoktrinuar nga ISIS-i është i vështirë për t'u përcaktuar. Një llogaritje e përafërt e numrit të fëmijëve të përfshirë, sipas Dr. Shelly Whitman është rreth *dy* qind mijë.<sup>4</sup> Ky numër përfshin të gjithë fëmijët që janë përfshirë për të çuar më tej synimet e grupit militant, dhe jo një llogaritje e fëmijëve në vijën e frontit të ISIS-it. Pavarësisht kësaj, sipas përkufizimeve për ushtarët fëmijë të miratuara në Parimet e Kejp Taunit, një ushtar fëmijë është një person nën moshën 18 vjeçare që është pjesë e forcave të rregullta ose të parregullta të armatosura që vepron në çfarëdo kapaciteti<sup>5</sup>, që e justifikon qartë kategorizimin e fëmijëve të përdorur nga ISIS-i si ushtarë fëmijë.

ISIS-i ka një përjasje të sofistikuar për të indoktrinuar fëmijët në radhët e tyre, si me qëllimin për të shtuar ushtarë në vijën e frontit, ashtu edhe për të krijuar mbështetës besnikë për regjimin. ISIS-i ka marrë nën kontroll shkollat për të garantuar mësimin e një programi mësimor të ashpër, fëmijët kontrollohen dhe nxënësit monitorohen nga afër. Raportohet gjithashtu se ISIS-i ka ngritur qendra të veçanta edukimi për fëmijët që janë edukuar në Perëndim. Ata kanë ngritur gjithashtu kampe specifike stërvitore ushtarake për ata që shihen si *besnikë* ndaj organizatës. Si në rastet e tjera të konfliktit të armatosur ku fëmijët janë përdorur si ushtarë, është e njohur se ISIS-i rrëmben fëmijë për t'i listuar ata në organizatë.<sup>6</sup> Masa të tjera më pak negative janë të zakonshme, duke përfshirë *dhënien e pagesave* familjeve që fëmijët të marrin pjesë në shkollat e ISIS-it, paradat publike që i joshin fëmijët me ëmbëlsira dhe lodra, si edhe hartimi i librave që glorifikojnë ISIS-in.<sup>7</sup>

<sup>1</sup> Bloom, Horgan dhe Winter, 2016

<sup>2</sup> Qendra e Lajmeve e OKB-së, 2014.

<sup>3</sup> Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut, 2015

<sup>4</sup> Logan, 2014.


<sup>5</sup> Wessells, 2006z

<sup>6</sup> Malik, 2016

<sup>7</sup> Malik, 2016



Bloom, Horgan dhe Winter kanë dokumentuar rolet e shumta që luajnë fëmijët brenda ISIS-it si edhe mënyrat e shumta se si ISIS-i i shfrytëzon fëmijët dhe ka ekzaminuar imazhe të shfrytëzimit të fëmijëve nga ISIS-i për qëllime propagandistike. Studimi i tyre jep një analizë të dobishme të moshës dhe kombësisë së fëmijëve që lavdërohen në propagandën e ISIS-it.<sup>8</sup> Për shembull, në figurën më poshtë shohim origjinat kombëtare të fëmijëve, të përshkruar si martirë, që shfaqen në propagandën zyrtare të ISIS-it.



**Figura 1.** Shteti i origjinës së fëmijëve të përshkruar si martirë në propagandën e ISIS-it<sup>9</sup>

Ndërkohë që shumica e fëmijëve janë sirianë ose irakianë, mund të shohim nga grafiku gamën e kombësive të paraqitura. Gama e kombësive pasqyron demografinë e të rriturve evropianë që kanë udhëtuar drejt Sirisë (duke qenë se shumica e fëmijëve sillet atje nga prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes), por kemi më shumë informacione rreth të rriturve evropianë në territorin e ISIS-it sesa për fëmijët. Peter Neumann nga Kings College London ka raportuar se 4000 të rritur evropianë kanë udhëtuar drejt Sirisë për t'u bashkuar me organizatat ushtarake<sup>10</sup>; nga këta llogaritet se 10% janë gra. Të dhënat e fëmijëve evropianë në Siri/Irak janë më të pjesshme. Në një raport nga fondacioni Quilliam sugjerohet se rreth 50 fëmijë britanikë po rriten aktualisht nën ISIS-in<sup>11</sup> në mënyrë të ngjashme edhe autoritetet franceze kanë sugjeruar se rreth 50 fëmijë të lindur prej prindërve francezë, janë çuar në territoret e kontrolluara nga ISIS-i.<sup>12</sup> Në një raport nga Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë, sugjerohet se ka shtatëdhjetë fëmijë me lidhje

<sup>8</sup> Bloom, Horgan dhe Winter, 2016

<sup>9</sup> Bloom, Horgan dhe Winter, 2016

<sup>10</sup> Neuman, 2015.

<sup>11</sup> Malik, 2016

<sup>12</sup> Bisserbe dhe Meichtry, 2015



holandeze në territoret e kontrolluara nga ISIS-i; shumica e të cilëve janë çuar nga prindërit, por disa kanë lindur atje.<sup>13</sup> Në rastin e Gjermanisë, llogaritet se në territoret e kontrolluara nga ISIS-i janë 24 deri 36 të rinj gjermanë, por vetëm në mars 2015, u larguan nga Gjermania për t'u bashkuar me ISIS-in 70 vajza të reja, duke përfshirë edhe 9 nxënese shkolle.<sup>14</sup>

Ndërkohë që është e vështirë llogaritja e fëmijëve që kanë udhëtuar nga Evropa drejt territoreve të kontrolluara nga ISIS-i, një e panjohur tjetër është numri aktual i fëmijëve të lindur (ose që do të lindin) në Siri ose Irak nga prindër evropianë. Duke qenë se raportet vlerësojnë se ka aktualisht 31 mijë gra shtatzëna në rajon, kjo mund të ketë implikime të konsiderueshme për menaxhimin e të kthyerve në Evropë.<sup>15</sup>

Ky dokument shpreh shqetësimin për fëmijët e kthyer në Evropë që kanë lindur ose kanë jetuar në territoret e kontrolluara nga ISIS-i në Siri/Irak. Ai shpreh gjithashtu shqetësimin për fëmijët joevropianë që kanë udhëtuar në Evropë si rezultat i zhvendosjes së detyruar. Çështja që duhet debatuar kur merret në konsideratë mënyra se si mund të menaxhojmë kthimin e këtyre fëmijëve është se ISIS-i kërkon t'i indoktrinojë të gjithë fëmijët, jo vetëm ushtarët fëmijë, që të bëhen pjesë e ideologjisë së tyre të dhunshme antiperëndimore; një ideologji që është në kundërshtim me normat sociale, kulturore dhe ligjore në shtetet evropiane. Menaxhimi i kësaj krize të pashmangshme është i rëndësishëm nëse synojmë të shmangim problemet e konsiderueshme psiko-sociale për fëmijët e përfshirë, por edhe çështjet e konsiderueshme ligjore dhe të komunitetit, duke pasur parasysh potencialin që disa fëmijë të vazhdojnë synimet e ISIS-it pas kthimit të tyre.

## **Sfidat për specialistët e parandalimit dhe shërbimet sociale – Trajtimi i traumave të fëmijërisë**

Grupet vulnerabël në shoqëri kanë më shumë mundësi që të ekspozohen ndaj pasojave të luftës; të pafuqishmit, të varfrit, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, të gjithë këta ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga konflikti i armatosur.<sup>16</sup> Fëmijët janë veçanërisht vulnerabël si për shkak të abuzimeve që ata pësojnë në mjedisin e konfliktit, ashtu edhe për shkak të dhunës që ata dëshmojnë, por edhe për shkak të faktit se zhvillimi i tyre normal social, moral, emocional dhe njohës ndërpritet dhe dëmtohet nga përvoja e luftës.<sup>17</sup>

Në përpjekje për të adresuar këtë traumë, çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD) mbetet kadri predominues i aplikuar për të kuptuar pasojat e fëmijëve që përjetojnë dhunën e konfliktit.<sup>18</sup> Si ndërhyrje, Terapia e Sjelljes Konjitive (CBT) e informuar rreth traumës ka treguar se është e efektshme si për fëmijët ashtu edhe për familjet e tyre në kapërcimin e vështirësive që lidhen me trau-

<sup>13</sup> Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë, 2016

<sup>14</sup> Anderson, 2016

<sup>15</sup> Malik, 2016

<sup>16</sup> De Jong, Berckmoes, Kohrt et al, 2015

<sup>17</sup> Kohrt, Jordans, Koirala, et al, 2014

<sup>18</sup> Fasfous, Peralta-Ramírez, dhe Pérez-García, 2013



mat.<sup>19</sup> Ndërkohë që është e përshtatshme një përfaqëse bazuar në traumën, ajo që i mungon këtij kuadri është njohja e faktit se jetesa ose socializimi në një shoqëri që vuan një konflikt të armatosur nuk është një ngjarje e vetme traumatike me një pikë të qartë përfunduese; jetesa me konfliktin e dhunshëm, veçanërisht në kontekste të paqëndrueshme politike, shpesh zhvillohet njëkohësisht me ekspozimin ndaj ngjarjeve të tjera traumatike.<sup>20</sup> Gërshetimi i rreziqeve ndërpersonale dhe psiko-sociale është i dokumentuar mirë<sup>21</sup> dhe si rezultat akademikët kanë përdorur termin rrezik akumulues për mundësinë që fëmijët e ekspozuar ndaj konfliktit të armatosur ka shumë të ngjarë të pësojnë trauma të shumta dhe të vazhdueshme<sup>22</sup>: dhunë ndërpersonale/brenda familjes, abuzim seksual, uri, kequshqyerje, neglizhim dhe braktisje. Ekspozimi ndaj traumave të shumta dhe të përsëritura përbën një rrezik të konsiderueshëm për zhvillimin e fëmijëve dhe funksionimin e përgjithshëm të tyre.<sup>23</sup> Përveç viktimizimit të përsëritur të përjetuar gjatë konfliktit të armatosur, një mundësi tjetër është traumatizimi i mëtejshëm si rezultat i proceseve të zhvendosjes dhe të riintegrit. <sup>24</sup> Ky viktimizim i përsëritur lidhet pikësisht me diskriminimin, mungesën e stabilitetit, papunësinë e prindërve dhe mungesën e rrjeteve të personave të afërt për mbështetje.

Ndërgjegjësimi për traumat duhet të jetë një aftësi kyçe e të gjithë individëve që punojnë me fëmijët e kthyer. Aftësia për të njohur shenjat dhe simptomat e traumës është thelbësore për interpretimin e saktë të sjelljes së fëmijëve. Për shembull, individët që kanë përjetuar trauma komplekse dhe të vazhdueshme janë të rrezikuar ndaj eksitimit të tepërt të kortizolit, që shkakton vdekje të qelizave në hipokampus.<sup>25</sup> Pasojat shoqërore përfshijnë vështirësi në leximin e nuancave faciale dhe shoqërore, reagime të larta alarmuese, shmangie, probleme me kujtesën, aftësi të këqija në vendimmarrje dhe agresivitet. Reagimet e lartpërmendura duhet të kuptohen si reagime “normale” të traumës, por ajo që është e rëndësishme është se këta faktorë nuk e lejojnë një fëmijë të përfshihet siç duhet në shërbimet e rrymës së përgjithshme. Specialistët dhe mjekët klinikë duhet të ristrukturojnë pikëpamje të tilla si “ngurrim për t’u përfshirë” në “bën përpjekje për t’u përfshirë”, duke përdorur praktikën e informuar rreth traumës. Përveç problemeve të përfshirjes, disa studime argumentojnë se nuk duhet të provohen ndërhyrje të konsiderueshme terapeutike për të paktën 6 muaj për shkak të nevojës që fëmija të përshtatet fizikisht dhe psikologjikisht me ambientin e ri. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet të ofrohet mbështetje, por fëmijët që kanë përjetuar trauma të rënda paraqesin probleme të veçanta dhe kjo mund të pengojë më tej përfshirjen në terapi. Për shkak të kësaj, një rekomandim kyç është që të ketë një punonjës çështjeje që lidhet me shërbimet e tjera përfshirëse që nevojiten nga fëmija dhe familja e tij, dhe që të shmanget me çdo kusht përfshirja e shumë punonjësve të çështjes.

Trajnimi për ndërgjegjësimin për traumat duhet të kryhet në të gjitha nivelet e organizatës, nga administrata deri te specialisti, çdo individ që mund të ketë kontakt me fëmijën ose familjen duhet

<sup>19</sup> Steel, M. & Malchiodi, C.A. (2010) Praktika e informuar rreth traumës me Fëmijët dhe Adoleshentët. Routledge, Nju-Jork.

<sup>20</sup> Catani, Gewirtz, Weiling, Schauer, Elbert, dhe Neuner, 2010

<sup>21</sup> Catani et al., 2010

<sup>22</sup> Ibid.

<sup>23</sup> Ibid.

<sup>24</sup> Fazel et al., 2012

<sup>25</sup> Van Der Kolk, 2006





të ndërgjegjësohet se trauma krijon ndjeshmëri ekstreme ndaj mbingarkesës ndijore, e manifestuar në reagimet e sjelljes dhe emocionale dhe në shkëputje.<sup>26</sup> Reagimet ndaj traumës bëhen pa dashje, trupi reagon përpara se të mendojë, dhe një shumëllojshmëri faktorësh mund ta aktivizojnë këtë reagim. Është e pamundur të krijohet një listë e faktorëve të mundshëm aktivizues, kjo është krejtësisht e personalizuar sipas përvojës individuale të çdo fëmije dhe lista e këtyre faktorëve është e pafund. Nuk mund të nënvleftësohet rëndësia e ndërgjegjësimit mes çdo pjesëtari të personelit në organizatë, për shembull përvojat në një sportel recepsioni apo dhomë pritjeje mund të aktivizojnë një reagim traume dhe si rrjedhojë të të ndikojnë në përfshirjen e mëtejshme në shërbim.<sup>27</sup>

Ç'është më e rëndësishme, duke pasur parasysh përvojat e tyre të kaluara, fëmijët e kthyer dhe familjet e tyre kërkojnë një sens fuqizimi për të pasur sukses në menaxhimin e traumës së tyre. Reagimet fiziologjike ndaj traumës krijojnë një sens humbjeje kontrolli, por gjithashtu për shkak të përfshirjes së tyre të mundshme në shërbimet e shërbimeve të sigurisë, shërbimet e emigracionit etj., edhe përvojat e tyre më të fundit mund të kenë qenë nën kontrollin e të tjerëve. Në këtë aspekt, fëmijët dhe familjet duhet të edukohen rreth simptomave të traumave të tyre dhe kjo duhet të aplikohet duke përdorur një gjuhë që fokusohet te pikat e tyre të forta. Reagimet fizike dhe psikologjike ndaj traumës janë normale, ato mund të prekin të gjitha aspektet e jetës, ato mund të menaxhohen dhe personi mund të shërohet. Individët duhet të ndihen se kanë të drejtë fjale në të gjitha vendimet që lidhen me rrethanat e tyre aktuale, objektivat duhet të jenë bashkëpunues dhe aty ku një shërbim i konsideron vendimet e marra nga fëmija/familja si vendime të dobëta, ato duhet të kuptohen nga pikëpamja e të mbijetuarit.<sup>28</sup> Specialistët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për faktin se një reagim normal ndaj traumës është pamundësi për t'u përfshirë personalisht dhe ky është një proces i ngadaltë gradual që mund të kërkojë muaj për t'u kapërcyer. Faktorët që rrisin mundësinë e përfshirjes janë mirëbesimi dhe zgjedhja, gjithashtu fëmijët dhe ata rrotull tyre janë në rrezik kur janë të izoluar.

## **Sfidat për specialistët e parandalimit dhe shërbimet sociale – Kuptimi i përfshirjes në dhunë nga fëmijët e kthyer**

Është e dokumentuar mirë që fëmijët që bëhen ushtarë fëmijë e bëjnë këtë kryesisht të detyruar, për të mos pësuar ndëshkime alternative, duke përfshirë edhe dhunën seksuale, për të shmangur martesën e detyruar, dhe/ose në përpjekje për t'iu larguar varfërisë ekstreme.<sup>29</sup> Në shumë raste, familjet janë bashkëpunëtores në procesin e rekrutimit si rezultat i detyrimit: ekonomik, të dhunshëm ose social.<sup>30</sup> Pavarësisht mjeteve ose motivit të rekrutimit, provat psikologjike tregojnë pa aftësinë e fëmijëve për të miratuar në mënyrë të mjaftueshme përfshirjen e tyre në aktivitete të dhunshme dhe mungesën e aftësisë së tyre për të kuptuar plotësisht pasojat e kësaj përfshirjeje.

<sup>26</sup> Van Der Kolk, 2006.

<sup>27</sup> Elliott et. al, 2005.

<sup>28</sup> Elliott et al., 2005

<sup>29</sup> Lamberg, 2004; Human Rights Watch, 2005

<sup>30</sup> Lakhani, 2010





Provat ekzistuese sugjerojnë se *miratimi* kërkon një aftësi njohëse që referohet si *mendim operacional formal*, një aftësi që zakonisht zhvillohet mes moshave 11-15 vjeç, megjithëse ekspozimi ndaj traumave mund të vonojë shfaqjen e tij.<sup>31</sup> Mendimi operacional formal lejon që fëmijët të përfshihen në mendim logjik (ndryshe nga mendimi emocional ose reagues). Aftësia e tyre për të kuptuar ose për të trajtuar pasojat e përfshirjes së tyre, mbështetet në zhvillimin e korteksit parafrontal, një zonë e trurit që është përgjegjëse për funksionet e rendit më të lartë (p.sh. planifikimin, pasojat, kontrollin e impulseve). Kjo strukturë e trurit nuk fillon me zhvillimin e tij kompleks deri në adoleshencë dhe ne tani e dimë se nuk zhvillohet plotësisht deri në fillim të të 20-ve.<sup>32</sup> Pavarësisht kësaj, ushtarëve fëmijë shpesh u kërkohet vendimi për t'u *bashkuar* me një organizatë paramilitare.<sup>33</sup> Megjithatë, në disa juridiksione në Evropë, aplikohet në kuadër zhvillimor brenda sistemit të drejtësisë penale për të llogaritur aftësitë njohëse të të rinjve të përfshirë në kriminalitet. Për shembull, në Danimarkë, moshë e përgjegjësisë penale është 15 vjeç, dhe kur fëmijët përfshihen në krime, reagimi diktohet nga situata individuale e fëmijës dhe jo nga serioziteti/natyra e krimit.<sup>34</sup> Por, pavarësisht provave rreth zhvillimit të fëmijës, kjo është një çështje e diskutueshme shoqërore dhe politike që nuk zgjidhet lehtë. Ish-fëmijët ushtarë viktimizojnë të tjerët, si brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre, prandaj të barazohen këta fëmijë me viktimat që *ata* kanë krijuar mund të shihet si një përpjekje për të justifikuar *zgjedhjen* e tyre pikësepari për të marrë pjesë në dhunë. Në fakt, këta fëmijë mbajnë *identitete të dyfishta si viktima dhe autorë krimesh* dhe kjo reflektohet në rolet e shumta që luajnë fëmijët në kontekstin e luftës.<sup>35</sup>

## Sfidat për specialistët e parandalimit dhe shërbimet sociale – Mësimet nga arena të tjera

Sigurisht, një shqetësim kyç për shërbimet e sigurisë dhe specialistët është mundësia që kur të rriten fëmijët e kthyer mund të vazhdojnë përfshirjen e tyre në dhunë politike. Kjo është absolutisht e panjohur dhe ka shumë të ngjarë të jetë e panjohshme, por nëse shohim konstatimet nga kriminologjia në lidhje me krimet jopolitike, njihet se fëmijët që kryejnë krime përpara moshës 12 vjeçare, ka më shumë të ngjarë të vazhdojnë të kryejnë krime.<sup>36</sup> Kjo nuk është detyrimisht e lidhur me krimet e dhunshme, por mund të jetë e lidhur me krime për drogat, sjellje varësie dhe keqpërshtatje e përgjithshme. Sërish është e panjohur si dhe nëse kjo ka lidhje me çështjen e ushtarëve fëmijë, por duhet të shërbejë të paktën si paralajmërim në lidhje me nevojën për ndërhyrje të hershme. Duke pasur parasysh se ISIS-i synon në mënyrë rutinë fëmijët para moshës së adoleshencës për rekrutim dhe indoktrinim,<sup>37</sup> çështja e ndërhyrjes së hershme bëhet edhe më urgjente.

Të dhënat e disponueshme rreth rolit të fëmijëve brenda ISIS-it tregojnë si sofistikimin ashtu edhe shumëllojshmërinë e shfrytëzimit të fëmijëve nga organizata dhe provat që kemi tregojnë nga-

<sup>31</sup> Santrock, 2001

<sup>32</sup> Steinberg et al., 2010

<sup>33</sup> Joyce et al, 2015

<sup>34</sup> Kyvsgaard, 2004

<sup>35</sup> Ibid

<sup>36</sup> Loeber, Farrington dhe Petechuk, 2003

<sup>37</sup> Malik, 2016



shmëritë mes situatës në Irak dhe Siri dhe fushatave të tjera ku fëmijët përdorshin si ushtarë nga organizatat paramilitare.<sup>38</sup> Një numër autorësh kanë dokumentuar shfrytëzimin e ushtarëve fëmijë nga ISIS-i duke ekzaminuar abuzimet që vuajnë fëmijët si edhe rolin e familjeve në rekrutim dhe radikalizim. Një studim u fokusua veçanërisht në procesin e socializimit në dhunë<sup>39</sup> dhe përshkroi një proces me gjashtë hapa duke përfshirë kontaktin me liderët karizmatikë, shfaqjen në një komunitet praktikimi, përforcimin e elementeve kyçe të identitetit dhe pjesëmarrjen në ritualet e përbashkëta<sup>40</sup>. Kjo provë duhet të përdoret për të kuptuar se si ISIS-i i ka rekrutuar fëmijët jo si ushtarë, por si anëtarë të një komuniteti të përcaktuar mirë me një identitet të veçantë dhe një grup social qartësisht të identifikueshëm. Ç'është më e rëndësishme, duhet të kuptohet se strukturat mbështetëse, identiteti dhe dinamikat e grupit të ofruara nga ISIS-i kanë krijuar rezistencë të fëmijët që duhet të dekonstruktohet dhe zëvendësohet me kujdes si pjesë e çdo ndërhyrjeje.

Mund të nxirren gjithashtu mësimë edhe nga përvoja e punës me ushtarët fëmijë në zona të tjera konflikti. Ekzistojnë ngjashmëri mes asaj që po dëshmojmë në Siri dhe në sjelljen e rekrutimit të Tigrave të Tamilit në Sri Lankë, rolit të fëmijëve si sulmues vetëvrasës për Boko Haram dhe rolin si grumbullues të informacioneve të inteligjencës për Fianna në Irlandën e Veriut<sup>41</sup> – krahu rinor i Ushtrisë së Përkohshme Republikane Irlandeze (PIRA). Mësimet nga këto fusha mund t'u ofrojnë shumë specialistëve që trajtojnë të kthyerit në Evropë. Një supozim i ndërhyrjeve të shumta të hartuara për t'u implementuar me fëmijët ushtarë është se ata mbeten në një zonë konflikti ose se janë në një shoqëri tranzicioni post-konflikti. Megjithatë, në rastin e të kthyerve në Evropë, për shkak të traumës që shoqërohet me zhvendosjen e detyruar, hyrjen në sistemin e birësimit dhe/ose burgosjen e prindërve, nuk është i paarsyeshëm supozimi se këta fëmijë do të *ekzistojnë* në një mjedis tranzicioni. Gjithashtu, specialistët mbështesin idenë se me ushtarët fëmijë duhet të përdoren ndërhyrjet për shëndetin mendor bazuar në prova për të aplikuar strategjitë psiko-edukative për të ndihmuar në menaxhimin e emocioneve dhe zhvillimin e aftësive ndërpersonale. Objektivi përfundimtar është të ndërtohen lidhje mes familjeve dhe komuniteteve, duke ofruar kështu rezistencë dhe stabilitet për fëmijën. Rikthimi i roleve civile si punësimi, shkollimi etj., është thelbësor në ndërtimin e vetëbesimit mes fëmijëve të traumatizuar<sup>42</sup>, por gjithashtu sepse shërben edhe si proces normalizues.

## Sfidat për specialistët e parandalimit dhe shërbimet sociale – Faktorët e rrezikut dhe të rezistencës

Kriza globale, qoftë lufta, uria apo katastrofat natyrore të gjitha kanë ndikim të fortë te fëmijët dhe grupet e tjera vulnerabël. Katastrofat jo vetëm që ulin sigurinë fizike të fëmijëve, por edhe mirëqenia e tyre afatgjatë vihet në rrezik për shkak të ndikimit në zhvillimin e tyre social, emocional,

<sup>38</sup> Malik, 2016; Horgan, Taylor et al, 2016

<sup>39</sup> Horgan, Taylor et al, 2016

<sup>40</sup> Horgan, Taylor et al, 2016

<sup>41</sup> Gill and Horgan, 2013

<sup>42</sup> Drexler, 2011.



moral dhe njohës.<sup>43</sup> Si me të gjitha kërcënimet ndaj mirëqenies së familjes qofshin këto ekspozimi ndaj disfunksionimit në familje, përfshirja në abuzim e substanca narkotike, apo vetë ekspozimi ndaj tyre dhe/ose përfshirja në dhunë terroriste, ekzistojnë faktorë të përbashkët rreziku dhe mbrojtës.<sup>44</sup>

Rreziqet biologjike ndoshta përcaktohen fillimisht gjatë periudhës para lindjes, pra truri dhe trupi që zhvillohen në barkun e nënës. Këta mund të jenë faktorë të jashtëm si substancat, dieta e keqe etj., megjithatë sidomos i rëndësishëm në këtë rast është ndikimi në zhvillimin e periudhave të stresit të fëmija.<sup>45</sup> Nëse nëna është vazhdimisht nën reagimin ndaj stresit fiziologjik, kjo ka një ndikim dëmtesues të fetusit që zhvillohet. Gjatë lindjes truri nuk është ende i zhvilluar dhe deri në moshën 6 vjeçare truri është rreth 90% i zhvilluar. Kërcënimet ndaj këtij zhvillimi në 1000 ditët e para konsiderohen me ndikim shumë të madh në aftësinë e fëmijës për t'u përfshirë në botën rreth tij.<sup>46</sup> Nëse fëmija është i ekspozuar ndaj stresit toksik ose traumës ku trupat e tyre aktivizojnë rregullisht reagime ndaj luftës ose arratisjeve, ndikimi është se komprometohet zhvillimi i sistemit nervor në tru. Stresi toksik mund të vijë nga një shumëllojshmëri burimesh; konflikti ndaj të cilit ekspozohen, por edhe Përvoja të tjera Negative të Fëmijërisë (ACE), të tilla si disfunksionimi në familje, abuzimi dhe neglizhimi. Ky stres akumulativ ka një efekt reagues sipas dozës; sa më i madh ekspozimi, aq më të mëdha rezultatet negative<sup>47</sup> ndërsa për ACE-t është konstatuar se shkaktojnë ndryshime strukturore në trurin që zhvillohet.<sup>48</sup> Megjithatë, ka shpresë në lidhje me kapacitetin rezistues të fëmijëve; studimet sugjerojnë se truri mund të “rihyjë në gjendjet plastike” në situatat e dhura dhe kështu i zbut këto pasoja negative. Në fakt, studimet më të fundit eksperimentale kanë sfiduar ato që më parë njiheshin rreth qarqeve të trurit, që konsideroheshin si rezistentë ndaj riprogramimit dhe rilidhjes. Studime të shumta laboratorike kanë sugjeruar se truri në fakt mund t'u përshtatet sfidave në mjedisin e vet, që Karatsoreos & McEwen<sup>49</sup> e përkufizojnë si rezistentë. Këto konstatime inkurajohen, dhe mbështesin përpjekjen për të synuar ata që mund të kenë përjetuar trauma në përpjekje për të zbutur pasojat e tyre negative. Kjo do të kërkojë krijimin e mjedisit të duhur brenda shërbimeve ekzistuese të informuara nga ajo që e dimë tashmë në lidhje me fëmijët që janë zhvendosur nga zonat e konfliktit, si dhe praktikë e informuar rreth traumës.

## Identifikimi dhe puna me fëmijët e rrezikuar

Çështja e identifikimit të fëmijëve të kthyer që kanë nevojë për ndërhyrje pas kthimit të tyre nga Siria, është si jashtëzakonisht komplekse ashtu edhe jashtëzakonisht e thjeshtë. Politika më e përshtatshme duhet të jetë që të gjithë fëmijët që kthehen nga Siria kanë përjetuar trauma dhe prandaj kanë nevojë për ndërhyrje vetëm sipas kësaj baze. Nëse do të konsideronim fëmijët që mund të jenë indoktrinuar ose *radikalizuar* me ideologjinë ekstremiste të ISIS-it, sërish duhet të

<sup>43</sup> Ager et al, 2010

<sup>44</sup> Fazel et al., 2012; Vakalahi, 2001

<sup>45</sup> Mulder et al., 2002

<sup>46</sup> Hair et al, 2012

<sup>47</sup> Felliti et al. 1998

<sup>48</sup> Mulder et al., 2002; Hair et al., 2012

<sup>49</sup> Karatsoreos & McEwen, 2013



konstatojmë se, duke parë sa larg shkon ISIS-i për të ekspozuar fëmijët ndaj botëkuptimit të tyre, të gjithë fëmijët duhet të supozohet se kanë marrë njëfarë përfshirjeje në ideologjinë ekstremiste të ISIS-it. Kjo nuk do të thotë aspak se të gjithë të kthyerit janë ekstremistë të dhunshëm, por që të kuptohet se ndaj fëmijëve do të jenë bërë përpjekje nga burime të ndryshme për t'i indoktrinuar dhe kështu mund ta kenë asimiluar këtë ideologji në veten e tyre, në konceptet e tyre për komunitetin dhe perceptimet e tyre për perëndimin.

Duke pasur këtë parasysh, një konsideratë kyçe në përpjekjet për të ndërhyrë te fëmijët e kthyer është roli i menaxhimit të identitetit dhe tranzicionit, si individual ashtu edhe social. Në një studim nga Lynch dhe Argomaniz<sup>50</sup> që ka ekzaminuar rolin e autorëve të krimeve në nismat e deradikalizimit, Pemberton foli rreth nevojës për të kuptuar përfshirjen në terrorizëm, jo sipas asaj që bëjnë njerëzit, por sipas zgjedhjeve të identitetit që u ofron atyre. Në fakt, Pemberton e ndërton terrorizmin më shumë si “Unë jam” sesa “Unë bëj”. Në rastin e fëmijëve kjo është veçanërisht e rëndësishme duke qenë se zhvillimi i identitetit të tyre është fluid dhe varet shumë nga përvojat e tyre të kulturës dhe komunitetit.<sup>51</sup>

Përveç çështjes së identitetit të fëmijëve të kthyer, rezistenca individuale (dhe ideologjia përkatëse) është një faktor jetësor shpesh i neglizhuar në procesin e radikalizimit dhe më pas të deradikalizimit. Rezistenca i referohet aftësisë së një fëmije për t'u përballur dhe për të reaguar si ndaj sfidave normale ashtu edhe ndaj atyre të jashtëzakonshme që ndodhin gjatë zhvillimit të tij. Paraqitet një çështje tepër ironike kur përpjekjet të kuptojmë pjesëmarrjen e fëmijëve në dhunën politike dhe ky është konstatimi se një fëmijë ka më shumë mundësi të jetë në gjendje të përballë me situatat traumatike nëse ka një sistem besimi të fortë fetar dhe ideologjik që shpjegon pse po i kalojnë këto vështirësi.<sup>52</sup>

Roli i përkushtimit ideologjik megjithëse nuk është studiuar sa duhet në rastin e fëmijëve dhe luftës, është i rëndësishëm psikologjikisht sepse një ideologji ofron kuptim në rastin e një traume të vazhdueshme dhe u lejon individëve të integrojnë ngjarjet në narrativën e jetës së tyre në mënyrë koherente.<sup>53</sup> Ky kuadër ideologjik shtrihet te perceptimi i dikujt rreth armikut të tij dhe një ndërtim bardhezi i armikut ofron një diferencim të qartë mes “nesh” dhe “atyre”, të mirëve dhe të këqijve; kjo ka implikime në gatishmërinë e dikujt për t'u përfshirë në veprime kundër armikut.<sup>54</sup> Prandaj, një ideologji mund të jetë psikologjikisht mbrojtëse për një fëmijë dhe për këtë arsye strategjitë e deradikalizimit që përpjekin të dekonstruktojnë indoktrinimin e kryer nga ISIS-i duhet të kenë parasysh vulnerabilitetet psikologjike ndaj të cilave mund të ekspozohen gjatë procesit. Tranzicioni i identitetit është një proces kompleks dhe afatgjatë<sup>55</sup> dhe për më tepër duke pasur parasysh nevojat delikate të zhvillimit të fëmijëve, mund të menaxhohet vetëm nga profesionistët që kuptojnë thellë origjinat dhe strukturat që e kanë mbajtur fëmijën gjatë kohës në territorin e

<sup>50</sup> Lynch & Argomaniz, 2016

<sup>51</sup> Phinney and Baldelomar, 2011

<sup>52</sup> Punamaki, 1996

<sup>53</sup> Ibid.

<sup>54</sup> Ibid.

<sup>55</sup> Shikoni për shembull një dokument mbi tranzicionin e individëve nga anëtarë të grupeve paramilitare në aktivistë të komunitetit: Joyce dhe Lynch, 2016



ISIS-it. Shembujt model zëvendësues, një komunitet i përshtatshëm dhe një grup aktiv personash të afërt janë të gjitha elemente të rëndësishme dhe të domosdoshme në proces gjatë përpjekjeve për të inkurajuar tranzicionin e identitetit. Siç është përmendur, roli i ideologjisë (ekstreme) dhe lidhja mes kësaj ideologjie dhe identitetit të fëmijës duhet të konsiderohet si faktor psikologjikisht mbrojtës për fëmijët që dalin nga një zonë konflikti, por edhe një reagim i pritshëm social ndaj vështirësive.

Kjo nuk mund të dekonstruktohet pa ofruar një mjedis të sigurt, jokërcënues, mbështetës ku mund të shfaqen mjete alternative të vetëmbrojtjes dhe identiteti mund të riinterpretohet në reagim ndaj ambientit të ri në të cilin e gjejnë veten.

Kjo tregon gjithashtu se fëmijët që përkrahin ideologji radikale dhe si rezultat tërheqin vëmendjen e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të sigurisë, mund ta bëjnë këtë për arsye që nuk lidhen me dhunën ose terrorizmin. Pasi ai mëson një mjet mbijetese në një zonë konflikti dhe pasi e integron këtë në identitetin e vet dhe sistemin e vet të vlerave, kjo ideologji duhet të konsiderohet se ka lidhje jo me atë që “Unë bëj” (ose mund të bëj) por me atë që “Unë jam”.<sup>56</sup>

Përveç çështjeve specifike për identitetin dhe ideologjinë, duhet të merret në konsideratë ndikimi psikologjik i zhvendosjes të fëmijët<sup>57</sup> gjatë planifikimit për ndërhyrje të fëmijët e kthyer. Modelet ekzistuese të shërbimeve psikologjike për fëmijët janë shumë të përshtatshme për të trajtuar fëmijët që kanë përjetuar trauma dhe si të tillë fëmijët e kthyer nuk ndryshojnë në kërkesat e tyre fundamentale. Megjithatë, shërbimet duhet të kenë parasysh mundësinë e traumatizimit të mëtejshëm të fëmijëve për shkak të statusit të tyre si refugjatë dhe përvojës së zhvendosjes. Për shembull, të qenit i mitur i pashoqëruar në një shtet pritës rrit rrezikun e psiko-patologjisë<sup>58</sup> dhe fëmijët që janë ndarë nga familjet e tyre pas zhvendosjes janë në rrezik më të lartë dëmtimi.<sup>59</sup>

## Ndërhyrja të fëmijët e kthyer dhe roli i familjes

Ndërsa familja është kryesore në ndërhyrjet të fëmijët në një shumëllojshmëri kontekstesh, në rastin e studimit të deradikalizimit, fokusi është pikësepari të roli i individit. Disa studime, si ato të kryera nga Malik dhe Russell<sup>60</sup> theksojnë nevojën që të konsiderohet dinamika psiko-sociale e familjes dhe se si kjo është e rëndësishme për të kuptuar radikalizimin, dhe përkatësisht deradikalizimin brenda njësisë të familjes. Në lidhje me deradikalizimin, mundësia që familja të ndikojë pozitivisht në këtë proces varet nga burimet e disponueshme për familjen, rrethet shoqërore të familjes dhe dinamikat unike të grupit të familjes. Karakteristika të tilla si punësimi i prindërve, stabiliteti familjar, aksesit në akomodim privat, një sens vetëvendosjeje dhe akses në arsim dhe mbështetje, të gjitha këto janë të nevojshme për të garantuar që familja të ketë kapacitetin për t’u përfshirë në programet e ndërhyrjes për të asistuar fëmijët e kthyer.

<sup>56</sup> Pemberton, 2016

<sup>57</sup> Bronstein & Montgomery, 2011; Hart, 2009

<sup>58</sup> Bean et al., 2007

<sup>59</sup> Hjern et al., 1998

<sup>60</sup> Malik and Russell 2016



Duke konsideruar rolin e familjes gjatë punës me fëmijët e kthyer, statusi i shëndetit mendor të prindërve ka treguar se ka efekt negativ në prezantimet emocionale dhe të sjelljes të fëmijët.<sup>61</sup> Duke qenë se në rastin e fëmijëve të kthyer, e gjithë familja mund të ketë pësuar traumë nga konflikti, ky është një rrezik i konsiderueshëm për mirëqenien e fëmijës. Gjithashtu, me një baba të papunë pas kthimit ose zhvendosjes, rritet rreziku i rezultateve negative.<sup>62</sup> Gjithashtu, fëmijët dhe familjet vuajnë efekte psikologjike negative kur strehohen me grupe në qendra pritjeje ose ndalimi kur krahasohen me ata që strehohen nga familjet.<sup>63</sup> Këto konstatime nga studimet e mëparshme me familjet e zhvendosura, tregojnë nevojën për t'u fokusuar në njësinë e familjes në vend të fokusimit në një individ gjatë përpjekjes për të ndërhyrë me ata që kthehen nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i. Në shumicën e rasteve, me mbështetjen dhe ndërhyrjen e duhur, familja do të veprojë si faktor mbrojtës kundër sjelljes problematike në çfarëdo forme që shfaqet.

Është gjithashtu e rëndësishme që të kuptojmë se mund të ketë raste ku familja është vetë faktori i rrezikut<sup>64</sup>; sepse e dimë se ka prova të fëmijëve të sjellë nga prindërit në territore të kontrolluara nga ISIS-i. Në këto raste, pas kthimit të tyre, *mund* të jetë e nevojshme që të konsiderohet largimi i fëmijës nga familja; ky do të ishte opsioni absolutisht i fundit sepse ndikimi të fëmija do të jetë i konsiderueshëm dhe i paparashikueshëm. Nëse kjo masë është e nevojshme, duhet të merret në konsideratë studimi i lartpërmendur, pra ndikimi i qendrave të ndalimit dhe jetesës në grupe. Reagim i përshtatshëm në këto raste është vendosja e fëmijëve në shtëpi birësuese me familje të së njëjtës origjinë etnike<sup>65</sup> duke ofruar një ndjesi stabiliteti<sup>66</sup> shoqëruar me mbështetje ndihmëse, veçanërisht në lidhje me shëndetin mendor dhe arsimimin.<sup>67</sup>

Përveç rolit të familjes më të gjerë në ndërhyrjet të fëmijët e kthyer, organizata Gratë pa Kufij thekson rolin e nënave në dallimin dhe luftimin e procesit të radikalizimit.<sup>68</sup> Puna e tyre është fokusuar kryesisht te luftëtarët e huaj të rritur dhe kështu nuk dihet se si gratë, veçanërisht nënat, mund të jenë pjesë e ndërhyrjeve të fëmijët e kthyer, sidomos duke qenë se nënat pikësëpari mund t'i kenë sjellë vetë fëmijët në territoret e kontrolluara nga ISIS-i. Megjithatë, përgatitja e nënave për të dalluar problemet e sjelljes dhe pajisja e tyre me njohuri se si të reagojnë ndaj këtyre sjelljeve, mund të shërbejë si sistem paralajmërues i hershëm kundër ekstremizmit të dhunshëm ose sjelljeve të tjera problematike. Literatura e kriminalistikës ka potencialin të kontribuojë në këtë debat duke pasur parasysh studimet e konsiderueshme që janë kryer rreth transmetimit të kriminalitetit brenda familjes,<sup>69</sup> rëndësia e grupeve të personave të përafërt në ruajtjen e deviancës<sup>70</sup> dhe konstatimet rreth ndalimit të krimeve *ndërkohë që personi rritet*.<sup>71</sup> Ashtu si me krimin jopolitik, përf-

<sup>61</sup> Ajduković, & Ajduković, 1993; Tousignant et al., 1999

<sup>62</sup> Tousignant et al., 1999

<sup>63</sup> Ajduković, & Ajduković, 1993

<sup>64</sup> Fazel et al., 2012

<sup>65</sup> Porte & Tournay-Purta, 1987

<sup>66</sup> Nielsen et al., 2008

<sup>67</sup> Kia-Keating & Ellis, 2007

<sup>68</sup> <http://www.women-without-borders.org>

<sup>69</sup> Farrington, Jolliffe, Loeber et al, 2001

<sup>70</sup> Fergusson, Swain-Cambell dhe Horwood 2001

<sup>71</sup> Farrington, 1986





shirja në dhunën politike është kryesisht proces social<sup>72</sup> dhe mbështetet nga marrëdhëniet dhe vlerat e komunitetit të shoqëruar me të. Kjo duket se sugjeron se luftimi i indoktrinimit të ISIS-it dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet t'i drejtohet natyrës sociale të përfshirjes, nga familja, te komunitet, te grupi i personave të afërt.

## Efeki i përhapjes – transmetimi i ideologjisë ekstremiste

Në rastet kur fëmijë të rritur janë kthyer nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i dhe presupozohet se kanë qenë dëshmitarë ose pjesëmarrës në dhunën ekstreme, ekziston rreziku që këta fëmijë të jenë më pak të hapur ndaj ndërhyrjes dhe më pak të aftë të ndryshojnë për shkak të statusit të zhvillimit të tyre. Gjithashtu, dhe e mbështetur nga literatura e kriminalistikës që tregon influencat e personave të afërt në kryerjen e krimeve<sup>73</sup>, duhet të ketë shqetësime të konsiderueshme rreth *përhapjes* së ideve radikale mes personave të afërt. Në raste të tilla, një rol në mentorimin e fëmijës mund të luajnë liderët e respektuar (nga fëmija) të komunitetit, ose drejtuesit e xhamisë që njohin kulturën përkatëse të të rinjve dhe që janë të aftë të komunikojnë në një nivel të përshtatshëm. Gjithashtu, ofruesit e edukimit mund të shërbejnë si mjet për të hapur interesa dhe rrethe alternative shoqërore për të rinjtë. Megjithatë, pavarësisht nga mosha e fëmijës, vazhdojnë të aplikohen zhvillimi i aftësive ndërpersonale, menaxhimi i emocioneve, pasja e një jete familjare të qëndrueshme etj. Përveç kësaj, është e rëndësishme që fëmijët më të rritur të menaxhohen në një shërbim të posaçëm me shërbimet kyçe (p.sh. psikologjike, edukative, pastorale) të përshtatura për nivelin e tyre të zhvillimit. Ata nuk duhet të përfshihen në shërbimet e të rriturve.

## Konkluzioni

Duke pasur parasysh ato që dimë rreth stresit toksik, rrezikut akumulues, rezistencës dhe plasticitetit, kur marrim parasysh popullatën e fëmijëve që ka jetuar në territoret e kontrolluara nga ISIS-i, nuk duhet të përpiqemi të identifikojmë ata që janë në rrezik që të kryejnë ekstremizëm në Evropë, por të identifikojmë ata individë që janë në rrezik dëmtimi personal dhe shoqëror. Në fakt, nëse i adresohemi traumës së fëmijëve individualë dhe familjeve të tyre, ne do të minojmë njëkohësisht themelet për sjellje problematike në të ardhmen - qoftë kriminalitet, dhunë apo terrorizëm. Trauma e përjetuar nga fëmijët gjatë jetesës në një zonë lufte, pavarësisht nëse kanë qenë apo jo pjesë e konfliktit, ka implikime gjatë gjithë jetës për atë individ dhe familjen e tij. Ndërhyrja duhet të ndjekë metodat e përcaktuara mirë të cilat theksohen më lart, të identifikuara për trajtimin e traumës së fëmijërisë në nivel individual dhe familjar. Kjo nuk do të thotë se fëmijët e kthyer nuk kanë rrethanat që janë unike për përvojën e tyre personale, sigurisht që çdo rast është i veçantë. Duhet diskutuar gjithashtu edhe disa faktorë në planifikimin për ndërhyrjen te fëmijët e kthyer, veçanërisht roli i identitetit dhe ideologjisë në mbajtjen e ideologjisë ekstremiste.

Për t'iu përgjigjur krizës aktuale, nuk duhen anashkaluar *njohuritë* e përcaktuara rreth zhvillimit normal. Për shembull, ndërveprimi pozitiv i personave të afërt është me rëndësi dhe mund të pa-

<sup>72</sup> Lynch dhe Joyce, 2017

<sup>73</sup> Fergusson, Swain-Cambell dhe Horwood 2001





rashikojë përshtatjen në fusha të tjera të përshtatjes psikologjike dhe sociale. Në fakt, literatura mbi refugjatët dhe të kthyerit fëmijë tregon se mbështetja sociale e personave të afërt është e ndërlydhur me shëndetin e mirë mendor dhe përshtatjen.<sup>74</sup>

Gjithashtu pjesëmarrja në arsim është faktor mbrojtës i konsiderueshëm dhe dështimi për t'u përfshirë dhe për të qëndruar në sistemin arsimor ndikon në mënyrë të konsiderueshme në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës.<sup>75</sup> Aty ku arsimi është bashkëpunues, ai sjell një ndjesi sigurie dhe demonstroi hapje ndaj diversitetit kulturor dhe rrit mirëqenien.<sup>76</sup> Faktorë të tjerë veçanërisht kur fëmijët janë vendosur nën kujdesin e shtetit, lidhen me një reduktim në numrin e zhvendosjeve që bënë një fëmijë, ofrimin e kujdesit individual të birësimit, shmangien e mbajtjes nën arrest dhe faktorëve mbështetës fetarë dhe kulturorë, të cilat janë të gjitha të dokumentuara si promovuese të një përshtatjeje më të mirë.<sup>77</sup>

Ndërkohë që nuk ka dyshim se fëmijët që kthehen nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i janë ekspozuar ndaj traumave që do të ndikojnë negativisht në mirëqenien e tyre, duhet pasur parasysh se kanë gjithashtu një kapacitet shumë të madh për shërim dhe rezistencë. Studimet në përballimin të fëmijët, theksojnë se të gjithë kanë kapacitetin të ndërtojnë rezistencë<sup>78</sup> dhe kjo varet nga faktorët mjedisorë që janë brenda sferës së influencës së shteteve evropiane. Bernard<sup>79</sup> shprehet se zotësia për të formuar marrëdhënie pozitive me personat e afërt dhe të rriturit, aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe autonomi, ndërton rezistencë dhe shërbimet ekzistuese kanë potencialin që t'u ofrojnë fëmijëve aftësitë e kërkuara. Është shumë e rëndësishme që politikat dhe procedurat e reja kanë një përjasje humanitare për menaxhimin e këtyre të kthyerve dhe faktorët e kuadrit të zhvillimit mund dhe duhet të reduktojnë mundësinë e shkakimit të mëtejshëm të viktimizimit, stresit dhe traumave duke mënjanuar si rrjedhojë rrezikun që fëmijët mund të paraqesin për të tjerët në të ardhmen.

## Rekomandimet

### Planifikimi i ndërhyrjes

1. Të gjitha ndërhyrjet duhet të jenë të bazuara në prova; për shembull specialistët duhet të ndërhyjnë aty ku ekzistojnë shqetësime legjitime (pjesëmarrje e dobët në shkollë, ekzistenca e dhunës në shtëpi). Shtetet anëtare mund të përdorin legjislacionin ekzistues për mbrojtjen e fëmijëve për të fituar akses te fëmija dhe familja, kjo duhet të bëhet me specialist të informuar rreth traumës.
2. Konsiderimi i ndërhyrjes të një fëmijë që rritet në një familje *radikale* është problematik. Në raste të tilla, ndërhyrja mund të shihet si diskriminuese dhe politike dhe mund të izolojë

<sup>74</sup> Almqvist & Broberg, 1999; Ekblad, 1993

<sup>75</sup> Fazel et al., 2012

<sup>76</sup> Kia Keating & Ellis 2007; Hart, 2009

<sup>77</sup> Fazel et al., 2012

<sup>78</sup> Bernad, 1995

<sup>79</sup> Ibid



fëmijën si edhe familjen. Në raste të tilla, mund të jetë e përshtatshme përfshirja në nivel komuniteti ose përmes mentorimit me personat e afërt.

3. Aty ku fëmijët e kthyer janë përfshirë në dhunë, një zgjidhje e drejtësisë penale ka potencialin të traumatizojë më tej fëmijën, të sjellë recidivizëm në të ardhmen dhe të kufizojë mundësitë për rehabilitim dhe riintegrim. Nëse i jepet prioritet një kuadri rehabilitues, atëherë nevojat dhe vulnerabilitetet e fëmijës kanë përparësi, pavarësisht nga natyra e krimit.
4. Ndërhyrja e hershme është jetësore për fëmijët nën moshën dymbëdhjetë vjeçare, për të maksimizuar mundësinë e rehabilitimit. Kjo duhet të aplikohet nga individë të kualifikuar dhe me kompetencë kulturore, të mbështetur nga komuniteti dhe rrjetet e njohura me ligj të profesionistëve.
5. Plotësimi i nevojave të fëmijëve të kthyer duhet të informohet nga praktika më e mirë ekzistuese e mbrojtjes së fëmijëve dhe të kryhet brenda rrjeteve kombëtare të themeluara të shërbimeve për fëmijët. OJQ-të dhe organizatat bamirëse shpesh nuk kanë kapacitetin ose lidhjet me të gjitha shërbimet e nevojshme për të kryer ndërhyrje vetëm dhe prandaj duhen mbështetur nga shërbimet ekzistuese të njohura me ligj.
6. Aty ku këto shërbime kanë ndërhyrë dhe është zhvilluar një plan përkujdesjeje për një fëmijë të caktuar, ekspertët e fushës (si liderët fetarë, liderët e komunitetit, dhe ata me përvojë në traumat e konflikteve) duhet të japin kontributin për korrigjimet e vazhdueshme të këtij plani, duke pasur parasysh njohuritë e tyre unike të çështjeve kyçe.
7. Psikologët ekspertët duhet të kontribuojnë në menaxhimin e çështjeve të identitetit dhe të ideologjisë së bashku me ekspertët e fushës (p.sh. ekspertët kulturorë, ekspertët rajonalë, liderët e komunitetit etj.) Kjo duhet të përfshijë një njohuri të thellë të procesit të indoktrinimit të përjetuar nga fëmija (konsultimi paraprak me familjen përpara takimit me atë fëmijë mund të ndihmojë në mbledhjen e këtij informacioni - edhe shërbimet e sigurisë mund të jenë në gjendje të japin informacione këtu)
  - a. Disponueshmëria e një *komuniteti alternativ* mbështetjeje do të jetë jetësor për ndërtimin e një identiteti të ri social. Këtë do ta ndihmojë mundësia e ndërtimit të marrëdhënieve nga fëmija.
  - b. Mund të ketë një rol, veçanërisht për fëmijët më të rritur, që ish-luftëtarë të huaj të përfshihen me fëmijën e kthyer, si për të shërbyer si shembull model pozitiv, por edhe për të asistuar në tranzicionin e identitetit. Kjo duhet të menaxhohet dhe të monitorohet me kujdes dhe duhet të jetë një proces i ngadaltë gradual.
  - c. Puna me njësinë e familjes rreth çështjeve të identitetit do të ndihmojë procesin e tranzicionit për fëmijën.
8. Rezistenca duhet të dallohet dhe të nxitet për të mbështetur fëmijën përmes një faze tranzicioni, pavarësisht se si mund të duket kjo rezistencë; mohimi, minimizimi, harrimi dhe glorifikimi i përvojave të tyre janë të gjitha strategji përballjeje që ne presim të shohim te fëmijët e kthyer. Është e rëndësishme që punonjësit e vijës së parë t'i kuptojnë këto procese si normale, dhe jo si patologjike dhe kështu të vazhdojnë përfshirjen në këtë bazë.



9. Duhet të bëhet dallimi mes mentorimit të të kthyerve nga zonat e konflikteve dhe ndërhyrjes të të kthyerit. Tek e para, shpesh mungon informacioni bazë nga burimet zyrtare në lidhje me fëmijët e kthyer duke përfshirë ekzistencën e tyre, mirëqenien, vendndodhjen etj. dhe në rastet kur ekziston, kërkohen procese më të mira për ndarjen e informacioneve mes shërbimeve të njohura me ligj dhe përtej kufijve.

#### Praktika e informuar rreth traumës

1. Për shkak të mundësisë të lartë që fëmijët e kthyer të kenë përjetuar dhe të kenë dëshmuar e në disa raste të kenë marrë pjesë në dhunë ekstreme (duke përfshirë dhunë seksuale) të gjitha ndërhyrjet duhet të zhvillohen rreth praktikës së informuar rreth traumës. Duhet marrë në konsideratë reagimet e kujdesit social krahasuar me reagimet e drejtësisë.
2. Shërbimet e mbështetjes që ekzistojnë tashmë në shërbimet e edukimit, kujdesit social dhe ato psikologjike, duhet të përdorin praktikën e informuar rreth traumës. Ekziston nevoja të pajisjen punonjësit socialë / punonjësit e çështjes dhe organizatat e tyre me kuadër organizativ të informuar rreth traumës për të mbështetur ndërhyrjet.

#### Roli i familjes në zhvillimin e ndërhyrjeve

1. Familjeve të refugjatëve/të kthyerve duhet t'u afroheni duke supozuar traumën edhe kur simptomat mund të mos jenë menjëherë të qarta.
2. Fëmijët duhet të mbështeten në kontekstin e familjes ku familja ka potencialin të jetë faktor mbrojtës, kjo kërkon mbështetjen e shëndetit mendor pozitiv të prindërve, stabilitetin dhe punësimin e tyre. Kjo ndodh veçanërisht në rastin kur fëmijët udhëtojnë vetëm drejt zonave të konfliktit - dhe më pas kthehen. Në këto raste përfshirja pozitive me familjen është prioritet për rehabilitimin dhe riiintegrimin e familjes.
3. Aty ku familja është faktor rreziku dhe kujdesi i njohur me ligj konsiderohet i përshtatshëm, fëmijët duhet të vendosen në një familje me origjinë të njëjtë etnike; duhet të shmangen shpëtitë me grupe dhe mbajtja nën arrest, një punonjës i vetëm duhet të mbajë lidhje me fëmijën dhe duhet të shmangët përfshirja e shumë punonjësve.
4. Fëmijët e kthyer dhe familjet e tyre duhet të përfshihen në mënyrë aktive në çdo vendim-marrje që ndikon në të ardhmen e tyre. Është i rëndësishëm për mirëqenien e individit dhe të grupit një sens kontrolli mbi jetën e vet.
5. Arsimi/punësimi i vazhdueshëm duhet të garantohet për të zbutur rreziqet e njohura personale dhe psiko-fizike për mirëqenien. Kjo aplikohet si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët.
6. Stabiliteti (familja, edukimi, mjedisi i shtëpisë, punonjësi i çështjes dhe shërbimet e mbështetjes) është jetësor për të mundësuar ndërtimin e marrëdhënieve që është i rëndësishëm për të garantuar përfshirjen dhe si rrjedhojë rehabilitimin.



## Referencat

1. Ager, A., Stark, L., Akesson, B. & Boothby, N. (2010) Defining Best Practice in Care and Protection of Children in Crisis- Affected Settings: A Delphi Study. *Child Development*, Volume 8 (4), pp. 1271-1286.
2. Ajduković, M., & Ajduković, D. (1993). Psychological well being of refugee children. *Child abuse & neglect*, vol. 17(6), pp. 843-854.
3. Almqvist, K., & Broberg, A. G. (1999). Mental Health and Social Adjustment in Young Refugee Children y 3½ Years After Their Arrival in Sweden. *Journal of the American Academy of Child & Adolescent Psychiatry*, vol. 38(6), pp. 723-730.
4. Anderson, K. (2016) Cubs of the Caliphate. The Systematic Recruitment, Training, and Use of Children in the Islamic State. IDC Paper. Available online at <https://www.ict.org.il/UserFiles/ICT-Cubs-of-the-Caliphate-Anderson.pdf> Accessed September 2016.
5. Bean, T., Derluyn, I., Eurelings-Bontekoe, E., Broekaert, E., & Spinoven, P. (2007). Comparing psychological distress, traumatic stress reactions, and experiences of unaccompanied refugee minors with experiences of adolescents accompanied by parents. *The Journal of nervous and mental disease*, vol. 195(4), pp. 288-297.
6. Bernard, B. (1995). Fostering resilience in children (Report No. EDO-PS-95-9). *Washington, DC: Department of Education. (ERIC Document Reproduction Service No.386327)*.
7. Berthold, S. M. (1999). The effects of exposure to community violence on Khmer refugee adolescents. *Journal of Traumatic Stress*, vol. 12(3), pp. 455-471.
8. Bisserbe, N. and Meichtry, S. (2015). French Children Add to ISIS Ranks. *The Wall Street Journal* Available online at <http://www.wsj.com/articles/french-children-add-to-isis-ranks-1451085058> Accessed September 11<sup>th</sup> 2016.
9. Bloom, M., Horgan, J.G. and Winter, C (2016) Depictions of Children and youth in the Islamic State's Martyrdom propaganda, 2015-2016. *CTCSentinal*, vol. 9(2), pp. 29-32.
10. Bronstein, I., & Montgomery, P. (2011). Psychological distress in refugee children: a systematic review. *Clinical child and family psychology review*, vol. 14(1), pp. 44-56.
11. Catani, C., Gewirtz, A., Weiling, E., Schauer, E., Elbert, T. & Neuner, F. (2010) Tsunami, War, and Cumulative Risk in the Lives of Sri Lankan Schoolchildren. *Child Development*, vol. 81 (4), pp. 1176-1191.
12. Dearden, L. (2016) Isis training children of foreign fighters to become 'next generation' of terrorists. *The Independent*, 29<sup>th</sup> July. Available online at <http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/isis-training-children-of-foreign-fighters-to-become-next-generation-of-terrorists-a7162911.html> Accessed September 02, 2016.
13. De Jong, JTVM., Berckmoes LH., Kohrt, BA, Song, S.J., Wietse, A.T. & Reis, R. (2015). A Public Health Approach to Address the Mental Health Burden of Youth in situations of Political Violence and Humanitarian Emergencies. *Current Psychiatry Reports*, vol. 17, pp. 60 –70.
14. De Roy van Zuijdewijn, J. & Bakker, E. (2014) Returning Western foreign fighters: The case of Afghanistan.
15. Bosnia and Somalia. *ICCT Background Note*. Available online at <https://www.icct.nl/download/file/ICCT-De-Roy-van-Zuijdewijn-Bakker-Returning-Western-Foreign-Fighters-June-2014.pdf> Accessed September 2<sup>nd</sup>, 2016.



16. Drexler, M. (2011) Life after death: Helping former child soldiers become whole again. Harvard Public Health, Available online at <https://www.hsph.harvard.edu/news/magazine/fall-2011/> Accessed September 11<sup>th</sup>, 2016.
17. Eichstaedt, P. (2009) First Kill Your Family: Child Soldiers of Uganda and the Lord's Resistance Army. Laurence Hill; Chicago.
18. Ekblad, S. (1993). Psychosocial adaptation of children while housed in a Swedish refugee camp: Aftermath of the collapse of Yugoslavia. *Stress Medicine*, vol. 9(3), pp. 159-166.
19. Farrington, D. (1986) Age and Crime. *Crime and Justice*, vol. 7, pp. 189-250.
20. Farrington, D., Jolliffe, D., Loeber, R. Stouthamer-Loeber, M. and Kalb, M. (2001) The concentration of offenders in families, and family criminality in the prediction of boys' delinquency. *Journal of Adolescence*, vol. 24, (5), pp. 579–596.
21. Fasfous, A. F., Peralta-Ramírez, I. & Pérez-García, M. (2013) Symptoms of PTSD among Children Living in War Zones in Same Cultural Context and Different Situations. *Journal of Muslim Mental Health*, vol. 7 (2) <http://hdl.handle.net/2027/spo.10381607.0007.203>
22. Fazel, M., Reed, R. V., Panter-Brick, C., & Stein, A. (2012). Mental health of displaced and refugee children resettled in high-income countries: risk and protective factors. *The Lancet*, vol. 379 (9812), pp. 266-282.
23. Felitti VJ, Anda RF, Nordenberg D, Williamson DF, Spitz AM, Edwards V, et al. (1998). Relationship of Childhood Abuse and Household Dysfunction to Many of the Leading Causes of Death in Adults. *American Journal of Preventative Medicine*, vol. 14(4), pp. 245–58.
24. Fergusson, D.M., Swain-Cambell, N.R. and Horwood, J. (2001) Deviant Peer Affiliations, Crime and Substance Use: A Fixed Effects Regression Analysis. *Journal of Abnormal Child Psychology*, vol. 30 (4) pp. 419–430.
25. Geltman, P. L., Grant-Knight, W., Mehta, S. D., Lloyd-Travaglini, C., Lustig, S., Landgraf, J. M., & Wise, P. H. (2005). The “lost boys of Sudan”: Functional and behavioral health of unaccompanied refugee minors resettled in the United States. *Archives of Pediatrics & Adolescent Medicine*, vol. 159(6), pp. 585-591.
26. General Intelligence and Security Services (2016) Life With ISIS the Myth Unravelling. Available online at <https://english.aivd.nl/binaries/aivd-en/.../2016/...isis-the-myth.../life-with-isis.pdf> Accessed September 11<sup>th</sup> 2016.
27. Gill, P. and Horgan, J. (2013) Who were the volunteers? The Shifting Sociological and Operational Profile of 1240 Provisional Irish Republican Army Members. *Terrorism and Political Violence*, vol. 25(3), pp. 435-456.
28. Hair, N. L., Hanson, J. L., Wolfe, B. L., & Pollak, S. D. (2015). Association of child poverty, brain development, and academic achievement. *JAMA pediatrics*, vol. 169(9), pp. 822-829.
29. Hart, R. (2009). Child refugees, trauma and education: interactionist considerations on social and emotional needs and development. *Educational Psychology in Practice*, vol. 25(4), pp. 351-368.
30. Hegghammer, T. (2011). The Rise of Muslim Foreign Fighters: Islam and the Globalization of Jihad.
31. *International Security*, Vol. 35 (3) pp. 53-94.
32. Hjern, A., Angel, B., & Höjer, B. (1991). Persecution and behavior: a report of refugee children from Chile. *Child abuse & neglect*, vol. 15(3), pp. 239-248.
33. Hjern, A., Angel, B., & Jeppson, O. (1998). Political violence, family stress and mental health of refugee children in exile. *Scandinavian Journal of Public Health*, vol. 26(1), pp. 18-25.



34. Horgan, J. G. (2014). *Psychology of Terrorism*. Routledge, London.
35. Horgan, J.G., Taylor, M., Bloom, M. & Winter, C. (2016) John G. Horgan, Max Taylor, Mia Bloom, and Charlie Winter. *Studies In Conflict & Terrorism* Accepted Author Version <http://dx.doi.org/10.1080/1057610X.2016.1221252>
36. Human Rights Watch (2005) *Sri Lanka: Child Tsunami Victims Recruited by Tamil Tigers*. Retrieved 6<sup>th</sup> of September 2016, from <http://www.hrw.org/news/2005/01/13/sri-lanka-child-tsunami-victims-recruited-tamil-tigers>
37. Karatsoreos N., & McEwen BS. (2013) Annual Research Review: The neurobiology and physiology of resilience and adaptation across the life course. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, vol. 54(4), pp. 337–47.
38. Jonson, B. (2016) Islamic State Securing Bloody Future With Army of ‘Cubs’. *The Observer*, 8<sup>th</sup> August. Available online at <http://observer.com/2016/08/islamic-state-securing-bloody-future-with-army-of-cubs/> Accessed September 8<sup>th</sup> 2016.
39. Joyce, C., Lynch, O. and Veale, A. (2015) Victims and perpetrators: A clinician’s account of ex-child soldiers and the child development process in Sri Lanka. In Argomaniz, J. & Lynch, O. (Eds) *International Perspectives on Terrorist Victimization: An Interdisciplinary Perspective*. Palgrave MacMillan, London.
40. Kia-Keating, M., & Ellis, B. H. (2007). Belonging and connection to school in resettlement: Young refugees, school belonging, and psychosocial adjustment. *Clinical Child Psychology and Psychiatry*, vol. 12(1), pp. 29- 43.
41. Koehler, D. (2015) Family Counseling, De-radicalization and Counter-Terrorism: The Danish and German programs in context in Aeiger, S. and Aly, A. **Countering Violent Extremism: Developing an Evidence-base for Policy and Practice**. Curtin University Press, Western Australia. pp. 129-143.
42. Kohrt, BA., Jordans, MJD., Koirala, S. et al (2014). Designing Mental Health Interventions Informed by Child Development and Human Biology Theory: A Social Ecology Intervention for Child Soldiers in Nepal. *American Journal of Human Biology*, vol. 27, pp. 27-40.
43. Kohrt, B. A., Jordans, M.J.D., Tol, W.A., Speckman, R.A., Maharjan, S.M., Worthman, C.A., Komproe, I.H. (2008) Comparison of Mental Health Between Former Child Soldiers and Children Never Conscripted by Armed Groups in Nepal. *JAMA*. Vol. 300(6), pp. 691-702.
44. Kyvsgaard, B. (2004). Youth justice in Denmark in Tonry, M. and Doob, A.N. (Eds.) *Youth Crime and Youth Justice: Comparative and Cross-National Perspectives*, pp. 349-390.
45. Leavitt, L.A., and Fox, N.A. (2014) *The psychological effects of war and violence on children*. Hillsdale, NJ
46. Lakhani, K. (2010) Pakistan’s child soldiers. *Foreign Policy*, March 29<sup>th</sup>. Available online at <http://foreignpolicy.com/2010/03/29/pakistans-child-soldiers/> Accessed 5<sup>th</sup> September 2016.
47. Lamberg, L. (2004) Reclaiming Child Soldiers’ Lost Lives *JAMA*, vol. 292(5), pp. 553-554.
48. Loeber, R., Farrington, D.P. and Petechuk, D. (2003) Child Delinquency: Early Intervention and Prevention. *Child Delinquency, Bulletin Series* (May). Available online at <http://www.forensiccounselor.org/images/file/Child%20Delinquency%20Early%20Intervention%20and%20Prevention.pdf> Accessed September 4<sup>th</sup> 2016.
49. Logan, N. (2014). Is the world ready to deal with a generation of ISIS child soldiers? *Global News*, available online at <http://globalnews.ca/news/1643057/is-the-world-ready-to-deal-with-a-generation-of-isis-child-soldiers/> Accessed September 11<sup>th</sup> 2016.





50. Lynch, O. (2013) British Muslim youth: radicalization, terrorism and the construction of the “other”. *Critical Studies in Terrorism*, vol. 6(2), pp. 241-261
51. Lynch, O. and Argomaniz, J. (2016) The Victimization Experience and the Radicalization Process – Understanding of the Perpetrator Victim Complex in the Case of Terrorism and Political Violence. Funded by the European Commission through the Specific Programme ‘Prevention of and Fight against crime’ HOME/2012/ISEC/AG/RAD
52. Lynch, O. and Joyce C.M. (2017) *The Group Processes of Terrorist Groups*. Blackwell Wiley, London.
53. McMullen, J., O Callaghan, P., Shannon, C. & Black, A. (2013) Group trauma-focused cognitive-behavioral therapy with former child soldiers and other war-affected boys in the DR Congo: a randomized controlled trial. *The Journal of Child Psychology and Psychiatry*, vol. 54 (11), pp. 1231–1241.
54. Mulder, E. J., De Medina, P. R., Huizink, A. C., Van den Bergh, B. R., Buitelaar, J. K., & Visser, G. H. (2002). Prenatal maternal stress: effects on pregnancy and the (unborn) child. *Early human development*, vol. 70(1), pp. 3-14.
55. Malik, N. (2016). The Children of Islamic State. *Quilliam Foundation*. Available online at <https://www.quilliamfoundation.org/wp/wp-content/uploads/publications/free/the-children-of-islamic-state.pdf> Accessed September 5<sup>th</sup> 2016.
56. Malik, N. & Russell, J. (2016) Countering Islamic Extremism; Challenges and Opportunities for Families. FATE and Quilliam. Available online [www.quilliamfoundation.org](http://www.quilliamfoundation.org) (Forthcoming)
57. ORG, (2013) Stolen Futures. The Hidden Toll of Child Casualties in Syria. Available online at [http://www.oxfordresearchgroup.org.uk/sites/default/files/Stolen%20Futures\\_0.pdf](http://www.oxfordresearchgroup.org.uk/sites/default/files/Stolen%20Futures_0.pdf) Accessed September 6<sup>th</sup> 2016.
58. Roberts, A. (2010) Lives and Statistics: Are 90% of War Victims Civilians?
59. *Survival* Vol. 52 (3), pp. 115-136.
60. Rousseau, C. (1995). The mental health of refugee children. *Transcultural Psychiatry*, vol. 32(3), pp. 299- 331.
61. Palosaari, E., Punamäki, R. L., Diab, M., & Qouta, S. (2013). Posttraumatic cognitions and posttraumatic stress symptoms among war-affected children: A cross-lagged analysis. *Journal of abnormal psychology*, vol. 122(3), pp. 656.
62. Pannell, I. (2015) Syria civilians still under chemical attack. BBC News, 10 September 2015. Available online at <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-34212324> Accessed September 8<sup>th</sup> 2016.
63. Pearn, J. (2003) Children and War. *Journal of Pediatrics and Child health*, vol. 39,(3), pp. 166–172
64. Phinney, J.S. & Baldelomar, O.A. (2011). Identity Development in Multiple Cultural Contexts in Jensen (Ed) *Bridging Cultural and Developmental Approaches to Psychology*. Oxford University Press, Oxford. pp. 161- 186.
65. Porte, Z., & Torney-Purta, J. (1987). Depression and academic achievement among Indochinese refugee unaccompanied minors in ethnic and non-ethnic placements. *American Journal of Orthopsychiatry*, vol. 57(4), pp. 536.
66. PunamAki, R.A. (1996) Can Ideological Commitment Protect Children’s Psychosocial Well-Being in Situations of Political Violence? *Child Development*, Vol. 67 (1), pp. 55-69
67. Santa Barbara, J. (2006) Impact of War on Children and Imperative to End War. *Croat Medical Journal* vol. 47(6), pp. 891–894.
68. Santrock, J. (2001). *Child Development*. New York: McGraw-Hill.





69. Somasundaram, D. (2002) Child soldiers: Understanding the context. *British Medical Journal, International edition* vol. 324 (7348) pp. 1268-71.
70. Spalek, B. (2016) Radicalization, de-radicalization and counter-radicalization in relation to families: Key challenges for research, policy and practice
71. *Security Journal*, vol. 29, (1) pp. 39–52.
72. Steinberg, L. (2010). Commentary: A behavioral scientist looks at the science of adolescent brain development. *Brain and cognition*, vol. 72(1), pp. 160 –172.
73. Syrian Observatory for Human Rights (2015). 52 Isis Child Soldiers Died Fighting in 2015; 19 Under-16 Jihadists Used as Suicide Bombers. Available online at <http://www.syriahr.com/en/?p=25985> Accessed September 11<sup>th</sup> 2016.
74. UN News Centre (2014) Security Council told of indiscriminate, brutal killings children face in conflict. Available online at accessed September 8<sup>th</sup>, 2016. <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=48659&Kw1=isis&Kw2=child+soldiers&Kw3=#.V9UXnldaHFJ>.
75. Vakalahi, H. (2001). Adolescent Substance Use and Family-Based Risk and Protective Factors: A Literature Review. *Journal of Drug Education*. vol. 31(1), pp. 29-46.
76. Wessells, M. (2006) Child Soldiers. From violence to protection. Harvard University Press, MA.
77. Yuhas, A. (2016). NATO commander: Isis ‘spreading like cancer’ among refugees. The Guardian Online, Tuesday 1 March 2016 Available online at <https://www.theguardian.com/world/2016/mar/01/refugees-isis-nato-commander-terrorists> Accessed September 2<sup>nd</sup> 2016.

Translated within:

